



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 1, datë 9.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL
"AKUAKULTURË DHE PESHKIM DETAR" PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE
TEKNIKE, NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS DHE ME
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

Mbështetur në nenin 75, nenin 80, shkronjën **dh** të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 64 në Statutin e UV-së, kreun **II** të Udhëzimit nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë me Universitetin Bujqësor të Tiranës me Nr. 775/16 prot të datës 19.11.2019, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit Master Profesional "Akuakulturë dhe Peshkim Detar". Ky Master do të jetë në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Departamenti i Shkencave Detare është përgjegjëse për hartimin e programeve të 4 (katër) lëndëve mësimore dhe për implementimin e tyre nga pikëpamja e mësimdhënies.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Detare.
4. Ky vendim së bashku me dokumentacionin përkatës të programit të studimit, sipas Udhëzimit nr. 31 datë 29. 12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

